



RAPORT VJETOR

1 Korrik 2015 - 30 Qershor 2016

Dorëzuar në Shtator 2016

Përmbajtja

I. Informacion bazë/Struktura e Projektit	4
II. Analiza strategjike dhe perspektiva	5
Kapitulli 1: Hyrje	7
Kapitulli 2: Rezultatet e arritura gjatë periudhës 2015 - 2016 (Viti 1)	9
Kapitulli 3: Produktet dhe performanca sipas Planit Vjetor Operacional 2015 - 2016	10
Kapitulli 4: Perspektiva gjinore	16
Kapitulli 5: Financat dhe menaxhimi	16
Kapitulli 6: Mësimet e nxjerra	17

Shkurtesat

BK	Bordi Këshillimor
GMS	Sistemi i Menaxhimit të Granteve
PPGj	Politika e Perspektivës Gjinore
BG	Bordi i Granteve
LA	LevizAlbania
OSFA	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
IMS	Instrumenti Mundësues Strategjik
PVO	Plani Vjetor Operacional
OSCH	Organizata të Shoqërisë Civile

I. Informacion bazë/Struktura e Projektit

Vendi: Shqipëri	Emri i projektit: LevizAlbania
Qëllimi	Qytetarët shqiptarë përfitojnë nga përmirësimi i demokracisë në nivel vendor
Rezultatet (Objektivat e Projektit, Synimi)	Rezultati 1: Aktorët e shoqërisë civile ndikojnë në përcaktimin e përparësive, në vendimmarrje dhe në mbikëqyrjen e autoriteteve vendore Rezultati 2: Aktorët e shoqërisë civile ndërmarrin dhe mbështesin ndryshime strukturore për të përmirësuar demokracinë në nivel vendor
Kohëzgjatja e fazës së projektit: 1 Korrik 2015 - 30 Qershor 2019	Periudha e raportimit: 1 Korrik 2015 - 30 Qershor 2016
Buxheti në dispozicion:	1,004,835 CHF
Informacion për kontributet e partnerëve dhe/ose donatorëve të tjerë (llogaritur në CHF): N/A	
Organizatat zbatuese:	OSFA, Co-PLAN, Partnerët Shqipëri
Partneri kryesor vendas: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA)	Partnerët kryesorë ndërkombëtarë: N/A
Drejtues Ekipi: Valbona Kuko	Numri i personelit të projektit: 9
Raporti i është dorëzuar Ambasadës Zvicerane në Tiranë, më: 15 Shtator 2016	

II. Analiza strategjike dhe perspektiva

Ky Raport Vjetor mbulon vitin e parë të operacioneve të LevizAlbania (këtej e tutje “LA”)¹. Raporti vjetor bazohet te raporti i ndërmjetëm dorëzuar Ambasadës Zvicerane pas gjashtë muajve të parë të zbatimit.

Deri tani, zbatimi i PVO/YPO-së së parë po ecën sipas planit. Në fakt, disa rezultate të ndërmjetme i kanë tejkaluar pritshmëritë, siç është pjesëmarrja e shoqërisë civile në Sesione të Informimit dhe numri i projekt-propozimeve të dorëzuara prej aktorëve e shoqërisë civile. Edhe vetë ekipi zbatues ka mësuar gjëra të reja të cilat i ka integruar në operacionet e projektit.

Gjatë gjashtë muajve të parë të projektit, partnerët kanë hedhur themelet e nevojshme për operacionet efektive afatgjata. Arritjet kryesore gjatë kësaj periudhe përfshijnë:

- Ngritjen e organeve drejtuese të nevojshme (Bordi Këshillimor, Bordi i Granteve);
- Përfundimin e procesit të punësimit të personelit dhe ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Granteve (SMG);
- Trajnimin e personelit mbi Protokollin e Perspektivës Gjinore dhe përdorimin e SMG-së;
- Realizimin e katër Sesioneve të Informimit me pjesëmarrje të lartë (338 pjesëmarrës në total);
- Shpalljen e Thirrjes nr. 1 për Aplikime e mbështetur nga një fushatë e fuqishme promovuese në media të ndryshme (Thirrja nr. 1 për Aplikime rezultoi në 22 kontrata granti nga 230 aplikime);
- Promovimin e LA duke shpërndarë informacion për publikun përmes faqes së internetit dhe mediave sociale.

Si përmbledhje e punës së bërë në gjashtë muajt e parë, LA arriti të krijojë me sukses infrastrukturën e projektit dhe të shpallë Thirrjen nr. 1 për Aplikime, duke ngjallur interesim të lartë te grupet kryesore të interesuara nëpër komunitete. Ky interesim u manifestua në pjesëmarrjen e lartë dhe në numrin e aplikimeve, si edhe në vëmendjen që i është kushtuar LA në media dhe në kanalet e saj në internet.

Kjo periudhë zbatimi është fokusuar në kontraktimin e grantmarrësve të Thirrjes nr. 1 për Aplikime dhe në përgatitjet për Thirrjen nr. 2 për Aplikime, bazuar në mësimet e nxjerra prej Thirrjes nr. 1 për Aplikime. Duke ndjekur zbatimin e mekanizmit të dhënies së granteve, ekipi mbledhi komente për Thirrjen nr. 1 për Aplikime dhe thjeshtoi procesin e aplikimit në disa aspekte që lidhen me hapat dhe dokumentacionin e kërkuar. Bazuar në këto përmirësime, LA shpalli Thirrjen nr. 2 për Aplikime me një qasje më të shënjestruar, me qëllimin që të tërheqë propozime në fushat e programit që ishin mbuluar më pak prej Thirrjes nr. 1 për Aplikime. Interesimi i aktorëve të shoqërisë civile (SHC) vazhdoi të jetë i lartë edhe në Thirrjen nr. 2 për Aplikime që rezultoi në 206 aplikime.

Gjatë vitit të raportimit, LA kontraktoi 22 grante (15 organizata dhe 7 individë) dhe një projekt në kuadrin e Instrumentit të Reagimit të Shpejtë. Mbi 500 pjesëmarrës morën pjesë në Sesione të Informimit në shtatë bashki. Stafi i LA zbatoi edhe aktivitetet mbështetëse për grantmarrësit. Konkretisht, LA organizoi Sesione Orientimi për grantmarrësit e Thirrjes nr. 1 për Aplikime dhe ka filluar Monitorimin në Terren me 8 vizita gjatë vitit të parë. Qëllimi i aktiviteteve mbështetëse ka qenë rritja e kapaciteteve të grantmarrësve në përgatitjen dhe zbatimin e aktiviteteve me ndikim në forcimin e demokracisë vendore. Mbështetja e dhënë përfshin aspekte specifike si zbatim praktik projekti, ekspertizë dhe këshillim i dhënë gjatë Sesioneve të Orientimit dhe vizitave të monitorimit në terren.

Në këtë periudhë raportimi, është ende herët për të vlerësuar rolin e grantmarrësve dhe ndikimin e projekteve të tyre në demokracinë vendore. Një analizë më e thelluar për ndikimin e këtyre trendeve do të realizohet gjatë viteve në vazhdim të aktiviteteve të LA.

¹ Viti i parë i zbatimit mbulon periudhën 1 Korrik 2015 - 30 Qershor 2016.

Si pjesë plotësuese e aktiviteteve të grantdhënies, LA vuri theksin edhe te shkëmbimi i përvojave mes OSHC-ve për sfidat lidhur me zhvillimin e demokracisë vendore. Për të arritur këtë qëllim, LA organizoi një eveniment të gjerë më 11 Prill 2016, me pjesëmarrjen e grantmarrësve të Thirrjes nr. 1 për Aplikime dhe të përfaqësuesve të qeverisjes qëndrore, për të shkëmbyer përvojat e tyre për problematikat e demokracisë vendore; aktiviteti pati pasqyrim të konsiderueshëm në media. Gjithashtu, LA realizoi një vlerësim të nevojave për ndërtimin e kapaciteteve, për të identifikuar aftësitë kryesore që iu duhen grantmarrësve në zbatimin e projekteve. Nisur nga ky vlerësim, në Qershor 2016 u organizua një trajnim tematik për grantmarrësit mbi "*Përdorimin e mjeteve TIK në forcimin e demokracisë vendore*", që u prit shumë pozitivisht nga pjesëmarrësit.

Të gjitha aktivitetet e mësipërme u përqëndruan në nivel vendor, duke iu mundësuar aktorëve të shoqërisë civile që të ndikojnë në përcaktimin e përparësive, në vendimmarrje dhe në mbikëqyrjen e autoriteteve vendore (Rezultati 1). Projekti synon edhe arritjen e ndryshimeve strukturore në nivel kombëtar (Rezultati 2). Megjithatë, këto aktivitete ishin planifikuar të fillonin në fund të vitit të parë. Viti i dytë do të hedhë dritë mbi ndikimin e nismave vendore të mbështetura, si edhe mbi progresin e bërë nga LA drejt arritjes së Rezultatit 2. Ndërsa gjatë vitit të dytë të zbatimit, LA do të konsolidojë mësimet dhe përvojën e fituar nga aktivitetet e vitit të parë dhe do të vazhdojë punën në këto shtylla programatike:

- Shpallja e dy *thirrjeve për aplikime* mbarëkombëtare, duke tërhequr deri në 100 aplikime për grante në secilën thirrje;
- Financim i reth 15 projekteve novatore dhe 5 granteve për individë për secilën thirrje për aplikime, duke punuar drejt përmirësimit të demokracisë vendore në mbarë vendin;
- Forcimi i mjedisit mundësues për grantmarrësit që të adresojnë problematikat strukturore që pengojnë demokracinë vendore;
- Forcimi i kapaciteteve të aktorëve të medias vendore për një rol më të theksuar në formësimin e demokracisë vendore;
- Zbatimi i ndërhyrjeve në kuadrin e Instrumentit Mundësues Strategjik (IMS) të LA;
- Garantimi i perspektivës gjinore në punën e LA dhe në projektet që do të mbështetë.

Kapitulli 1: Hyrje

LevizAlbania punon për forcimin e demokracisë vendore duke kultivuar një shoqëri civile me bazë lokale, e nxitur nga kërkesat e komunitetit dhe me ndikim në nivel rajonal në mbarë vendin. Njëkohësisht, LA ndërmer projektet strategjike, advokim në nivel kombëtar që të mundësojë një mjedis për përmirësimin dhe qëndrueshmërinë e demokracisë vendore. Ndërhyrja nisët nga premisa, apo "teoria e ndryshimit", që presupozon se ndërtimi dhe konsolidimi i kulturës së qeverisjes përfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse kërkon forcim progresiv të kërkesës së qenësishme për qeverisje më të mirë. Për të arritur këtë, projekti shfrytëzon këto instrumente:

- *Grantet me bazë Kërkese, Grantet Individuale dhe Asistencën e Reagimit të Shpejtë* për aktorët e shoqërisë civile (OJF-të, organizatat me bazë lokale, mediat, institucionet akademike, grupet rinore dhe grupet e grave, si edhe individët "avokatë të demokracisë"), që jepen pjesërisht përmes Konkurseve të Ideve që janë nisma publike me profil të lartë në nivel vendor në mbarë Shqipërinë.
- *Instrumenti Mundësues Strategjik (IMS)*, që është projektuar të shfrytëzojë pikat e forta të brendshme të LA si: (1) nxitës dhe mundësues i reformës; (2) ndërtues i kapaciteteve vendore të shoqërisë civile dhe (3) avokat strategjik për ndryshime të gjera. IMS do të shtojë ndërhyrjet që nxitin dhe mundësojnë një gamë të gjerë aktiviteteve për demokracinë vendore në Shqipëri dhe do të rritë premisat që ato të mbështeten.

Gjatë hartimit të programit, LA i ka kushtuar vëmendje të veçantë Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II (SKZHI II), që është dokumenti bazë i Shqipërisë për zhvillimin. Më konkretisht, indikatorët e rezultateve të LA lidhen ngushtë me Shtyllën: *Qeverisja e mirë, demokracia dhe shteti i së drejtës* i SKZHI II (2015-2020)². Rezultatet e LA kontribuojnë në 3 nga 13 sektorët/komponentët e SKZHI II. Gjithashtu, 6 nga 7 indikatorët e rezultateve të LA janë në përputhje me 5 Objektivat Strategjike dhe 6 qëllimet/instrumentet përkatëse të SKZHI.

Gjatë periudhës së raportimit ka pasur ndryshime thelbësore për sa i përket mjedisit mundësues për demokraci vendore në Shqipëri. Këto ndryshime përfshijnë krijimin së fundmi të 61 bashkive³, miratimin nga Qeveria të Strategjisë Kombëtare ndërsektoriale për Decentralizmin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020 dhe miratimin e Ligjit për Vetëqeverisjen Vendore. LA ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në diskutimet për ligjin e ri, ku ka theksuar rëndësinë që ka konsultimi me grupet e interesuara në përgatitjen e Rregullores për Këshillat Vendorë, për të forcuar të drejtat e qytetarëve që të ushtrojnë ndikim në proceset e vendimmarrjes vendore (neni 18, pika 1 e Ligjit).

Gjithashtu, LA ka vëzhguar edhe prirjet/trendet makro në sferën e shoqërisë civile shqiptare, për sa i takon mjedisit të përgjithshëm ligjor, kapacitetit organizativ të OSHC-ve, zhvillimeve që lidhen me advokimin dhe qëndrueshmërinë financiare të sektorit të OSHC-ve. Raportet më të fundit të USAID në 2015, *Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve*⁴ dhe *Matrica e Monitorimit për Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile*⁵ japin një analizë të fushave të sektorit të OSHC-ve. Më konkretisht, raportet nënvizojnë këto problematika:

- *Kapacitetet organizative të OSHC-ve* nuk janë përmirësuar gjatë vitit 2015. Sipas raporteve, OSHC-të kanë bërë progres duke rritur vizibilitetin në mediat sociale (kryesisht në Facebook dhe Twitter). OSHC-të kanë pasur një qasje më të hapur dhe përfshirëse në bashkëpunimin e tyre me median dhe në përdorimin e medias sociale në zbatimin e aktiviteteve dhe nismave të tyre. Gjithashtu, OSHC-të e kanë përdorur median sociale më me efektivitet në mbrojtjen/advokimin e kauzave të tyre me

² SKZHI II është e organizuar në Shtylla, Objektiva Strategjike dhe qëllime/instrumente për objektivat strategjike.

³ Në vijim të Reformës së re Administrativo-Territoriale 2014.

⁴ Realizuar nga IDM, prezantuar më 14 Korrik 2016: <https://www.usaid.gov/europe-eurasia-civil-society>.

⁵ Realizuar nga Partnerët Shqipëri, prezantuar në Mars 2016 : <http://partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-civil-society-development-country-report-for-albania-2/>.

qeverinë dhe komunitetin e donatorëve. Mangësia është se këto përpjekje kanë mbetur të izoluara dhe sporadike, duke arritur me vështirësi të grupet e synuara, si komuniteti rom, gratë në zonat rurale apo popullsia e madhe në moshë;

- Për sa i përket *prirjeve/trendeve të advokimit*, pavarësisht përfshirjes së OSHC-ve në shumë nisma advokimi gjatë vitit, kapacitetet e advokimit dhe lobimit të OSHC-ve nuk patën ndryshim të ndjeshëm në vitin 2015. Edhe pse angazhimi i OSHC-ve në konsultimet me qeverinë dhe parlamentin janë më të institucionalizuara, si rezultat i ligjeve të reja dhe strukturave institucionale, përfshirë Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile, është ende herët për të vlerësuar ndikimin e këtyre mekanizmave të rinj. Për më tepër, shumica e fushatave të advokimit vazhdojnë të realizohen në kryeqytet, ndërsa OSHC-të vendore rrallë organizojnë fushata advokimi në zona rurale dhe komunitete të largëta⁶;
- Viti i kaluar ka sjellë vetëm përmirësime të kufizuara në *qëndrueshmërinë financiare* të OSHC-ve vendore, pavarësisht përmirësimit të mjedisit financiar-ligjor. Qëndrueshmëria financiare është një nga sfidat kryesore për sektorin e OSHC-ve, pasi sektori shpenzon fondet e donatorëve dhe mbështetja e donatorëve të huaj përbën burimin kryesor të të ardhurave financiare;
- Për sa i përket *mjedisit ligjor* ku operon shoqëria civile, të dy raportet vënë në dukje se mjedisi ligjor për OSHC-të është përmirësuar gjatë vitit 2015 me miratimin e disa akteve ligjore.

Ndryshimet kryesore të kuadrit ligjor gjatë vitit 2015 përfshijnë:

- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 459 "Për miratimin e Udhërrëfyesit për hartimin e Politikave të Qeverisë Shqiptare dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile";
- Ligjin nr. 119/2015 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile KKSHC", miratuar nga Parlamenti më 6.11.2015. Ky ligj ka si qëllim të institucionalizojë bashkëpunimin dhe dialogun e përhershëm ndërmjet qeverisë dhe OSHC-ve. Ligji rregullon objektivin, përbërjen dhe rregullat e funksionimit të KKSHC-së dhe supozohet të garantojë autonominë e KKSHC-së⁷;
- Ligjin nr. 112/2015 "Për inspektimin financiar publik", miratuar më 15.10.2015. Ligji ka si qëllim të garantojë mbrojtjen kundrejt keqmenaxhimit financiar të fondeve publike (përfshirë fondet që i jepen qeverisë nga BE-ja dhe donatorë të tjerë), mashtrimit dhe korrupsionit;
- Projekt-ligjin për Vullnetarizmin i cili është dërguar në Parlament në Tetor 2015. Ky projekt-ligj synon rregullimin ligjor të punës vullnetare me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së individëve në jetën qytetare, përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet dhe mbështetjen e vlerave të solidaritetit njerëzor;
- Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 62 "Për shpalljen e standardit kombëtar të kontabilitetit të OJF-ve dhe zbatimin e detyrueshëm të tij", miratuar më 17.09.2015.

⁶ Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2015, USAID.

⁷ Kjo është nismë ligjore e shoqërisë civile, e udhëhequr nga Partnerët Shqipëri.

Kapitulli 2: Rezultatet e arritura në 2015-2016 (Viti 1)

LevizAlbania synon të arrijë dy Rezultate kryesore:

Rezultati 1: *(me fokus nivelin vendor):* Aktorët e shoqërisë civile ndikojnë në përcaktimin e përparësive, në vendimmarrje dhe në mbikëqyrjen e autoriteteve vendore.

Rezultati 2: *(me fokus nivelin kombëtar):* Aktorët e shoqërisë civile ndërmarrin dhe mbështesin ndryshime strukturore për të përmirësuar demokracinë në nivel vendor.

Gjatë periudhës së raportimit, pothuaj i gjithë theksi është vënë në marrjen e hapave për arritjen e Rezultatit 1. Edhe pse është herët për të parë materializimin e indikatorëve të rezultateve, LA ka bërë progres të konsiderueshëm me *indikatorët e produkteve të projektit*, bazuar në harkun kohor përkatës dhe të renditur më poshtë për Rezultatin 1.

Rezultatet (Objektivat e Projektit)	Indikatorët	Burimet dhe Mjetet e Verifikimit
<p>Rezultati 1:</p> <p>Aktorët e shoqërisë civile ndikojnë në përcaktimin e përparësive, në vendimmarrje dhe në mbikëqyrjen e autoriteteve vendore.</p>	<ol style="list-style-type: none"> Aktorët e shoqërisë civile (qytetarët, grupet civile, mediat, dhe autoritetet publike) po angazhohen gjithnjë e më shumë në përcaktimin dhe formësimin e prioritetëve vendore dhe shërbimeve publike, e konfirmuar në > 50% të bashkive; Aktorët e shoqërisë civile po ndërmarrin gjithnjë e më shumë advokim dhe monitorim të miratimit të kërkesave të tyre dhe të zbatimit të planeve, buxheteve, shërbimeve publike, etj. të qeverisjes vendore, e konfirmuar në > 50% të bashkive; Media ka marrë rol më domethënës në forcimin e demokracisë vendore, e konfirmuar në > 25% të bashkive. 	<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja në Konkursat e Ideve; Pjesëmarrja në trajnime dhe në Sesione të Orientimit; Anketat e qytetarëve; Monitorimi i LA dhe të dhënat agregate nga LevizBarometër.

Ndërkohë që shumica e hapave konkretë janë bërë drejt arritjes së Rezultatit 1, LA ka bërë progres edhe në hedhjen e themeleve për produktet e Rezultatit 2. Projekte të hollësishme në kuadrin e Rezultatit 2 si *Forcimi i OSHC-ve për përfshirje dhe pjesëmarrje efektive në politikëbërje dhe vendimmarrje*, si edhe *Platforma me të Dhënat Financiare Bashkiake* i janë dorëzuar Ambasadës Zvicerane, e cila deri tani ka miratuar vetëm këtë të fundit. *Platforma e Hapur me Të Dhëna Financiare* po projektohet për të ofruar të dhëna të besueshme dhe sistematike për performancën financiare dhe gjendjen fiskale të qeverisjes vendore në Shqipëri. Platforma synon të nxitë advokimin mbi bazë faktesh ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshirë dhe të interesuar në çështjet e qeverisjes vendore.

Gjatë vitit të parë, Co-PLAN ka ndërmarrë hapa domethënës drejt formalizimit të partneriteteve rreth kësaj platforme: hartoi Termat e Referencës ndërmjet partnerëve (Co-PLAN dhe Ministria e Financave) dhe e bëri platformën funksionale, duke e populluar me informacion për periudhën 2008-2013. Platforma www.financatvendore.al funksionon që nga Dhjetori 2015 dhe gjatë Sesioneve të Informimit të LA, iu është prezantuar si burim informacioni të gjithë aplikantëve potencialë.

Projekti i dytë IMS *Forcimi i OSHC-ve për përfshirje dhe pjesëmarrje efektive në politikëbërje dhe vendimmarrje* do të forcojë si sektorin e OSHC-ve në ciklin e zbatimit të projektit, por edhe demokracinë vendore, përmes trajnimeve dhe këshillimit të zgjeruar duke përdorur mjete dhe instrumente të ndryshme.

Ekipi do të konsolidojë këto hapa përgatitorë në vitin e dytë dhe do të fillojë procesin e zbatimit. Aktivitetet kryesore do të përfshijnë përmirësimin teknik të platformës, përgatitjen e një analize vjetore të situatës aktuale financiare të bashkive dhe ofrimin e trajnimeve për grupe të ndryshme të synuara.

Kapitulli 3: Produktet dhe performanca sipas Planit Vjetor Operacional 2015-2016

Siç u tha më lart, aktivitetet në vitin e parë u përqëndruan në ngritjen e infrastrukturës së nevojshme për ta bërë projektin të suksesshëm. Gjithashtu, LA ka bërë progres në zbatimin e masave të planifikuara për të arritur qëllimet nën Rezultatit 1. Më poshtë jepen arritjet kryesore në fusha të ndryshme:

Rezultati 1: *(me fokus nivelin vendor):* Aktorët e shoqërisë civile ndikojnë në përcaktimin e përparësive, në vendimmarrje dhe në mbikëqytjen e autoriteteve vendore.

Produkti 1: Grantet me bazë kërkesë dhe grantet individuale që jepen përmes Konkursit të Ideve janë të mirë menaxhuara.

I. Thirrjet për Aplikime

Gjatë periudhës së raportimit, LA shpalli dy Thirrje për Aplikime ku u dorëzuan mbi 400 aplikime. 22 grantmarrës janë kontraktuar nga Thirrja nr. 1 për Aplikime që nga Prilli 2016, ndërsa është në proces faza e dytë⁸ e Thirrjes nr. 2 për Aplikime.

Thirrja për Aplikime nr. 1: Para zhvillimit të raundit të parë të thirrjeve për aplikime, LA iu desh të punonte në terren për të garantuar ekspozimin maksimal dhe të kuptuarit të projektit në mbarë Shqipërinë. Në këtë kontekst, Thirrja ka pasur publicitet të lartë në shumë kanale. Njoftimi është publikuar në faqen e internetit, në katër gazeta të mëdha (Panorama, Shqiptarja.com, Shqip dhe Mapo) dhe në Ballkanweb dhe News 24 TV, duke gjeneruar interesim të lartë. Thirrja për Aplikime u shpall zyrtarisht më 10 Nëntor 2015, përmes një fushate komunikimi të fuqishme. Pjesëmarrësve iu la 30 ditë kohë që të dorëzojnë një propozim të shkurtër në një nga drejtimet e paracaktuara:

- Drejtimi 1: Institucionalizimi i pjesëmarrjes domethënëse të qytetarëve në vendimmarrje, priorizim, planifikim, formulim buxheti, ofrim shërbimesh (pjesëmarrja e qytetarëve);
- Drejtimi 2: Akses i rritur dhe i qëndrueshëm i qytetarëve në informacionin publik dhe përmirësimi i shërbimeve publike (informimi dhe transparenca);
- Drejtimi 3: Fuqizimi i medias për forcimin e demokracisë vendore (media si mjet advokimi);
- Drejtimi 4: Rritja e llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar publikë në nivel vendor (llogaridhënia);

Këto katër drejtime mundësonin liri të konsiderueshme për të zgjedhur fushat e projekteve, me synimin për të sjellë ide nga një gamë e gjerë problematikash që kanë të bëjnë me demokracinë.

Shembuj nga fusha #1 – grupi rinor ATA, Kamëz

“ATA” ose “THEM” është një grupim rinor i themeluar nga të rinj që jetojnë në qytetin e Kamzës. Qëllimi i projektit ishte forcimi i kapaciteteve të rinisë përmes përfshirjes së shoqërisë civile, si edhe gjetja e zërit të përbashkët në identifikimin dhe adresimin e çështjeve të qeverisjes vendore. Qëllimi madhor i projektit ishte që këta të rinj të bëhen Udhëheqës aktivë të së Ardhmes.

Këta të rinj po angazhojnë të rinj të tjerë të zonës që të ushtrojnë presion mbi Bashkinë Kamëz për të hapur Pallatin e Kulturës për qytetarët e Kamzës, sidomos për rininë; për të ngritur Këshillin Rinor, Rrjetin e Aktivistëve dhe një grup për monitorimin e qeverisjes vendore, si mënyra më e mirë për përfshirjen e të rinjve në vendimmarrjen vendore.

⁸ Gjatë periudhës së raportimit, LA seleksionoi Koncept-Idetë dhe në Korrik 2016 organizoi të tre Konkursat e Ideve.

Gjatë kësaj periudhe raportimi, LA organizoi Sesione Informimi në 7 bashki (për të dy thirrjet për aplikime), me 436 pjesëmarrës në total (rreth 60% e tyre femra). Interesimi publik për Sesionet e Informimit të Thirrjes nr. 1 për Aplikime ishte jashtëzakonisht i lartë, ku morën pjesë 338 aplikantë potencialë nga 17 bashki⁹, ose 28% e numrit total të bashkive. Ky numër pjesëmarrësish ishte 4.3 herë më i lartë sesa parashikimi në PVO/YPO.

Pjesëmarrja në Sesionet e Informimit të Thirrjes nr. 1 për Aplikime, ku morën pjesë kryesisht përfaqësues të OJF-ve dhe medias, individë e studentë, është ndarë si vijon:

- Shkodër (17 Nëntor, 2015) - 69 pjesëmarrës (41 prej tyre femra);
- Tiranë (20 Nëntor, 2015) - 139 pjesëmarrës (90 prej tyre femra);
- Korçë (24 Nëntor, 2015) - 68 pjesëmarrës (32 prej tyre femra);
- Vlorë (26 Nëntor, 2015) - 62 pjesëmarrës (28 prej tyre femra).


Në faqen e internetit të LA është hapur edhe një blog i posaçëm për t'iu përgjigjur Pyetjeve të Shpeshta (FAQs) drejtuar LA përmes e-maileve dhe gjatë Sesioneve të Informimit. LA mori gjithsej 40 pyetje gjatë kohëzgjatjes së Thirrjes, të cilat kanë marrë përgjigje brenda 24 orësh nga marrja e tyre.

Falë Sesioneve të Informimit dhe fushatës mediatike dhe të komunikimit që realizoi ekipi, në Thirrjen për Aplikime u dorëzuan projekt-ide në një numër më të lartë aplikimesh sesa parashikohej. Në total, LA mori 230 propozime të ndara si vijon:

- 169 aplikime për grante nga organizatat joqeveritare, përfshirë organizatat e medias;
- 61 aplikime nga individë. 58 nga 61 aplikimet përfaqësonin grupe qytetarësh.

Vetëm 16.9% (39 aplikime) e aplikimeve nuk plotësonin kriteret e Thirrjes për Aplikime dhe u përjashtuan nga vlerësimi i plotë. Aplikimet vinin nga 59 prej 61 bashkive. Bashkitë me numrin më të madh të aplikimeve ishin Tirana dhe Shkodra. Ndarja e propozimeve sipas fushave jepet më poshtë:

Grafiku 1: Projekt-propozimet sipas drejtimeve



⁹Shkodër, Lezhë, Pukë. Tiranë, Elbasan, Librazhd, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër, Berat, Lushnjë, Kukës, Dibër, Devoll, Pogradec, Fier dhe Durrës.

LA organizoi tre Konkurse Idesh rajonale për Thirrjen nr. 1 për Aplikime. Konkursët e Ideve ishin aktivitete të hapura, që tërhoqën grupe të ndryshme pjesëmarrësish, përfshirë këtu aplikantë dhe përfaqësues të organizatave të donatorëve/ndërkombëtare. Gjatë gjashtë ditëve të Konkurseve të Ideve¹⁰ ishin rreth 200 pjesëmarrës. Secili aplikant i përzgjedhur paraqiti idenë e vet para Bordit të Granteve. Në fund të Konkursit të Ideve, Bordi i Granteve shpalli publikisht aplikantët e miratuar me kusht. LA mundësoi transmetimin direkt të të gjithë procesit të Konkurseve të Ideve në faqen e vet të internetit (www.levizalbania.al/live-stream) që u ndoq nga rreth 1,000 shikues. Në përfundim të Konkurseve të Ideve, 45 aplikantëve iu rekomandua të hartonin propozime të plota dhe si rezultat u kontraktuan 22 projekte deri në Prill 2016 në kuadrin e Thirrjes nr. 1 për Aplikime.

Rreth 30% e granteve të kontraktuara janë grante për individë (7 nga 22 grante të kontraktuara¹¹). Për sa i përket mbulimit gjeografik, projektet do të kenë ndikim në 19 bashki dhe 2 projekte shtrihen në nivel kombëtar. Tri organizata të medias dhe tri gazetarë janë kontraktuar nën Thirrjen nr. 1 për Aplikime.

Në tërësi, grantmarrësit e përzgjedhur ishin brenda pritshmërisë së LA, por procesi i përzgjedhjes ishte sfidues, për shkak se shumë aplikantë ishin fokusuar më pak te projektet me bazë veprimi, duke preferuar qasjet më tradicionale si studimet apo diskutimet në tryeza të rumbullakëta.

Shembuj nga fusha #2 – Forumi i Mendimit të Lirë

Qëllimi i këtij projekti ishte që Kryetarët e Bashkive të jepnin llogari për mbajtjen e premtimeve të tyre zgjedhore, me shtrirje në 4 bashki: Tiranë, Lezhë, Elbasan dhe Vlorë. Projekti do të punojë drejt këtij qëllimi duke hartuar raporte mbi punën e bërë prej Bashkisë krahasuar me premtimet zgjedhore, përmes përfshirjes së qytetarëve në dialog direkt me drejtuesit e tyre vendorë përmes takimeve publike ballë-për-ballë dhe përmes rritjes së rolit të medias tradicionale dhe medias sociale në këtë proces monitorimi.

Produktet kryesore të kësaj nisme përfshijnë një faqe interneti (www.unëmonitoroj.al), 8 takime publike vendore me kryetarët e bashkive, 2 reportazhe televizive të thelluara, se sa kryetarët e bashkive i kanë mbajtur premtimet e tyre, mes të tjerash.

Më 12 Prill 2016, LA organizoi një Sesion Orientimi me grantmarrësit e Thirrjes nr. 1 për Aplikime - 39 pjesëmarrës (rreth dy pjesëmarrës për grant) u informuan gjerësisht mbi detyrimet kontraktuale, raportimin financiar dhe përkrahues, LevizBarometrën, komunikimin me median dhe perspektivën gjinore të LA.

Thirrja për Aplikime 2: Thirrja nr. 2 për Aplikime u shpall më 26 Prill 2016 dhe u fokusua në disa fusha që mungonin në Thirrjen nr. 1 për Aplikime. Ekipi analizoi edhe proceset e veta të brendshme dhe shfrytëzoi komentet nga Thirrja nr. 1 për Aplikime për të thjeshtuar dokumentacionin e kërkuar dhe përmbajtjen e tij (shih hollësitë të kapitulli i dedikuar mësimëve të nxjerra nga LA). Pjesëmarrësve iu dha 20 ditë për të paraqitur një propozim të shkurtër në një nga drejtimit e paracaktuara:

- Drejtimi 1: Advokimi dhe lobimi për të përmirësuar politikën vendore;
- Drejtimi 2: Rritja e llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar publikë në nivel vendor (llogaridhënia).

Thirrja u promovua fuqishëm në 5 gazeta kombëtare, (Panorama, Mapo, Shqiptare, Shqip, Shqiptarja.com), në dy portale *online* (www.lapsi.al dhe www.balkanweb.com), si dhe në faqet e internetit të LA dhe pjesëtarëve të Konsorciumit të saj: OSFA, Partnerët Shqipëri dhe Co-PLAN. Media sociale e LA arriti në 61,819 persona, me 669 klikime postimesh të ridrejtuar te www.levizalbania.al. Për më tepër, LA përgatiti

¹⁰ Konkursët e Ideve u organizuan në: Shkodër 10-11 Shkurt 2016, Durrës 18-19 Shkurt 2016 dhe Elbasan 23-24 Shkurt 2016.

¹¹ Lista e granteve të kontraktuara: http://www.levizalbania.al/slideshoë_item/levizalbania-shpall-fituesit-e-thirrjes-se-pare-per-aplikime/.

një video promovuese për të udhëzuar aplikantët dhe për të shpjeguar vetë Thirrjen. Videoja ishte shumë e suksesshme, duke arritur rreth 35,000 shikime.

LA organizoi tri Sesione Informimi në Thirrjen nr. 2 për Aplikime, konkretisht:

- Lezhë (5 Maj, 2016) - 39 pjesëmarrës (27 prej tyre femra);
- Fier (9 Maj, 2016) - 38 pjesëmarrës (24 prej tyre femra);
- Gjirokastrë (10 Maj, 2016) - 22 pjesëmarrës (13 prej tyre femra).

Kjo Thirrje tërhoqi 206 aplikime, përfshirë 67 aplikime për grante nga individët. Ekipi i LA vuri re një rritje të vogël në përqindjen e aplikimeve për individët mes dy thirrjeve për aplikime. Përveç kësaj, 16% e aplikimeve totale ishin bërë nga aplikantë që kishin aplikuar pa sukses në Thirrjen nr. 1 për Aplikime. Qëllimi i aplikimeve ishte që të shtriheshin në 61 bashki.

Në Thirrjen nr. 2 për Aplikime, LA përzgjedhi 50 aplikantë për fazën e Konkursit të Ideve (17 aplikantë individë dhe 33 organizata aplikante). LA do të jetë në gjendje të japë informacion të hollësishëm për Thirrjen nr. 2 për Aplikime në periudhën e raportimit vijues. Ndërsa këto dy thirrje për aplikime krijuan interesimin e fuqishëm të publikut, u vu re se aplikantët kanë shumë për të bërë për sa i përket dorëzimit të koncept-ideve më cilësore dhe me përmbajtje më novatore. Ky është një proces afatgjatë zhvillimi ku kontribut do të japë edhe LA përmes aktiviteteve të rritjes së kapaciteteve në vitet në vazhdim.

II. Asistenca e Reagimit të Shpejtë

LA ka bërë progres edhe me asistencën e Reagimit të Shpejtë që u krijua dhe u promovua përmes udhëzimeve praktike *online* për përdoruesit. Gjatë vitit të parë, LA kontrakttoi një projekt me fokus mbrojtjen mjedisore të lumenjve në veri të Shqipërisë. Projekti zhvillohet në Parkun Kombëtar të Luginës së Valbonës, ku ndërtimi i planifikuar i 12 hidrocentraleve kërcënon biodiversitetin dhe ekosistemin lokal. Qëllimi i projektit është të rrisë bashkëpunimin brenda komunitetit lokal, të informojë mbi projektet e hidrocentraleve dhe të mobilizojë qytetarët që të veprojnë për të parandaluar ndërtimin e hidrocentraleve të planifikuara. Kjo do të realizohet përmes këtyre masave:

- Identifikimin e mangësive ligjore dhe teknike në dokumentacionin e koncesionit për projektet e hidrocentraleve;
- Informimin dhe mobilizimin e komunitetit (takime lokale, workshop-e, etj.);
- Advokimin pranë institucioneve përkatëse (Ministria e Energjisë, Ministria e Mjedisit) për të marrë masa të menjëhershme.

Instrumenti mbështetës i Reagimit të Shpejtë është promovuar gjerësisht në median sociale dhe në aktivitetet e LA, si Sesionet e Informimit. Sidoqoftë, cilësia e ideve të dorëzuara është larg pritshmërisë së LA.

Produkti 2: Qeverisja vendore bëhet më reaguese ndaj kontributit dhe kërkesave të qytetarëve.

Më 11 Prill 2016, LA organizoi një **aktivitet në shkallë të gjerë** me të gjithë grantmarrësit dhe përfaqësuesit e qeverisjes vendore për të ndarë përvojën e tyre mbi demokracinë vendore dhe sfidat përkatëse në zonat e tyre. Ky aktivitetet u kombinua me prezantim publik nga grantmarrësit.

Produkti 3: Kapacitetet e OSHC-ve dhe individëve për të influencuar në demokracinë vendore përmirësohen.

Një komponent kyç i LA është të lehtësojë ndërtimin e kapaciteteve të përfituesve financiarë të projektit. Vlerësimi i nevojave për trajnim të grantmarrësve kaloi përmes një procesi tërësor dhe gjithëpërfshirës.

Si hap të parë, LA hartoi një listë me trajnime tematike/tema pas një diskutimi dhe analize të brendshme, bazuar në projektet e miratuara me kusht nga Konkursi i Ideve. Lista eidenton 7 (shtatë) grupe të mëdha

për trajnime tematike, që mbulojnë një listë të gjerë problematikash që lidhen me demokracinë vendore, si edhe jep informacion praktik për organizimin e ri dhe funksionimin e qeverisjes vendore, përdorimin e TIK-ut për zhvillimin e demokracisë vendore, Media si Advokuese kundrejt Medias si MP, perspektiva gjinore në kontekstin e qeverisjes vendore, etj. Një pyetësor i lehtë për përdoruesit u përgatit dhe iu shpërnda 45 grantmarrësve të miratuar me kusht të Thirrjes nr. 1 për Aplikime. Bazuar në përgjigjet e tyre, LA identifikoi dy tema kryesore që u konsideruan si boshllëqe/mangësi dhe relevante për aktorët e shoqërisë civile që merren me demokracinë vendore, konkretisht: informimi i thelluar për qeverisjen vendore dhe përdorimi i mjeteve të TIK-ut. Trajnimi i parë mbi "Përdorimin e mjeteve TIK në ndërtimin e demokracisë" u zhvillua në Qershor 2016 dhe morën pjesë 22 grantmarrës.

LA ka realizuar një grup aktivitete që lidhen me menaxhimin e projektit, komunikimin dhe monitorimin; këto aktivitete të planifikuara bazoheshin te Rezultatet/Produktet gjatë periudhës së raportimit.

1. Organizimi dhe menaxhimi i Projektit

Pas nënshkrimit të kontratës më 1 Korrik 2015, ekipi vendosi të krijojë infrastrukturën bazë për realizimin e projektit. Para fillimit të aktiviteteve kryesore, LA mblodhi një tryezë të rrumbullakët ndërsektoriale me mbi 40 përfaqësues nga qeveria, shoqëria civile, media, organizatat donatore (përfshirë Ambasadën Zvicerane) për të marrë komente mbi PVO/YPO 1¹². Kontributi i tyre ndihmoi në finalizimin e PVO/YPO 1 dhe njëkohësisht rriti ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e segmenteve të gjera të shoqërisë.

LA, me përfshirjen aktive të Ambasadës Zvicerane, ka ngritur Mekanizmin Drejtues të Projektit, si Bordi Këshillimor dhe Bordi i Granteve (BG), që përbëhen nga individë të shquar me përvojë të gjerë në fushën e shoqërisë civile, qeverisjes së mirë dhe gazetarisë. BG ka qenë shumë aktiv gjatë periudhës së raportimit, në përzgjedhjen e granteve dhe individëve (më shumë hollësi jepen nën Produktin 1). Paralelisht me këtë zhvillim, pjesëtarët e ekipit për pozicionet të mbetura vakante u përzgjedhën dhe u punësuan me kujdes, nga një grup i gjerë profesionistësh me përvojë. Personeli më pas u trajnuar mbi përdorimin e Sistemit të Menaxhimit të Granteve (SMG) dhe mbi Protokollin e Perspektivës Gjinore të LA.

2. Qasja ndaj komunikimit

Si pjesë e PVO/YPO 1 e LA, ekipi përgatiti një strategji të hollësishme komunikimi, me qëllim që të përdorë të gjitha kanalet e nevojshme për të rritur audiencën e aktiviteteve të LA dhe që të angazhojë sa më shumë komunitetet dhe grupet e ndryshme të interesuara për qëllimet e LA. Një nga aktivitetet e para të komunikimit ishte edhe ai për nisjen e projektit, organizuar më 8 Janar 2016 në Shkodër, me pjesëmarrjen e figurave të larta publike (zv. Kryeministri Z. Peleshi, Ambasadori Zviceran Z. Graf dhe Kryetarja e Bashkisë Shkodër, Znj. Voltana Ademi), që u transmetua direkt nga media, si kanalet televizive Report A1 and TV News 24.

Kanalet *online* luajnë rol të rëndësishëm në shtrirjen e komunikimit të përgjithshëm të LA. Faqja e internetit e LA është plotësisht funksionale dhe përditësohet rregullisht. Numri i vizitorëve unikë është rritur gjatë vitit, p.sh. për tremujorin e fundit ishte 6,544 kundrejt 3,638 vizitorë unikë në Dhjetor 2015. Faqja e internetit është promovuar fuqishëm në kanalet e mediave sociale të LA (Facebook, Twitter e Instagram), për të arritur audiencë më të madhe nëpërmjet materialeve të shpërndara nga faqja në këto platforma. LA hapi llogari në mediat sociale si Facebook dhe Twitter dhe i rifreskon rregullisht me përditësime dhe informacion rreth LA dhe aktiviteteve të grantmarrësve. Deri më sot, LA ka 4,485 ndjekës në Facebook, 46 në Twitter, 195 në Instagram, 151 shikues në kanalën YouTube dhe 1 mijë shikues në UStream, kanali ku LA transmetoi direkt të gjitha aktivitetet, veçanërisht Konkursin e Ideve.

Marrëdhëniet e ngushta të punës me gazetarët kanë qenë gjithashtu një objekt kryesor për LA. Ekipi ka filluar zhvillimin e këtyre marrëdhënieve në disa mënyra, duke e përdorur këtë bashkëpunim si mjet

¹² Aktiviteti u organizua më 29 Tetor 2015.

advokimi dhe jo vetëm si instrument për vizibilitet. Së pari, LA ka 6 grante të kontraktuara (3 individë dhe 3 organizata) që përfaqësojnë aktorët e medias. Gazetarët gjithashtu ftohën në të gjitha aktivitetet që LA ka organizuar në bashki të ndryshme. LA ka filluar përgatitjen e artikujve që synojnë promovimin e çështjeve të parashikuara nga grantmarrësit, si sfidat mbi të drejtën e informimit dhe konsultimit publik nga ana e bashkive. Këto artikuj pritet të publikohen në Shtator 2016.

LA ka rritur ndërgjegjësimin publik për projektin duke u shfaqur në 12 intervista në programe të njohura televizive dhe radiofonike. Konkursët e Ideve për Thirrjen nr. 1 për Aplikime u transmetuan në televizionet kombëtare dhe lokale, gazetatat dhe portalet *online* të lajmeve. Konkursët e Ideve të kësaj Thirrje të organizuara në Shkodër, Durrës dhe Elbasan u transmetuan në televizionet kombëtare dhe lokale, gazetatat dhe portalet *online* të lajmeve. Dy televizione kombëtare, RTSH dhe Top Channel, si edhe mbi 5 televizione lokale në secilin qytet i kushtuan mjaft hapësirë këtij aktiviteti në emisionet e tyre të lajmeve, si edhe publikuan aplikantët e kualifikuar. Aktiviteti u pasqyrua në 2 gazeta dhe 5 portale *online*.

Në kuadrin e punës ndërgjegjësuere, LA ka filluar përgatitjen e dy minidokumentarëve. Njëri prej tyre ka si temë përvojën e pesë grantmarrësve që punojnë me grupet në nevojë në zonat e largëta. Kjo është një mundësi për të gjithë grantmarrësit e LA të Thirrjes nr. 1 për Aplikime që të motivojnë dhe të angazhojnë sa më shumë qytetarë në nisma që forcojnë demokracinë vendore në komunitetet e tyre. Ndërsa dokumentari i dytë fokusohet te projekti i Reagimit të Shpejtë lidhur me ndërtimin e pesë hidrocentraleve të vogla mbi lumin Valbonë, në veri të vendit.

E fundit por jo nga rëndësia, është përgatitur një listë e gjatë me e-mailet e rreth 700 OSHC-ve që operojnë në Shqipëri. Kjo listë është organizuar sipas qarqeve dhe është përdorur për të shpërndarë informacion rreth LA.

3. Monitorimi dhe vlerësimi

22 grantmarrësit e Thirrjes nr. 1 për Aplikime kanë plotësuar LevizBarometri-n dhe përgjigjet janë agreguar. Përfituesit e granteve nënvizuan si vërejtje kryesore faktin se situata e qeverisjes vendore në lidhje me elementët kryesorë të demokracisë vendore (pjesëmarrja, transparencja dhe llogaridhënia) ka nevojë për përmirësim të konsiderueshëm. Grantmarrësit ngritën si sfidë kryesore në zonat e tyre mungesën e transparencës në bashki dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, duke pasur parasysh zbatimin e dy ligjeve kryesore: "*Për të drejtën e informimit*" dhe "*Për njoftimin dhe konsultimin publik*".

Grantmarrësit theksuan edhe se shumë bashki nuk kanë faqe interneti efektive dhe mungon transparencja në punën dhe aktivitetet e bashkive. Kjo situatë bëhet më problematike kur bëhet fjalë për njoftimin e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak (që mbizotëron në shumicën e bashkive ku operojnë grantmarrësit). Për më tepër, instrumentet që bashkitë përdorin për përfshirjen dhe konsultimin e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nuk garantojnë përfshirje apo efikasitet, sidomos në lidhje me buxhetin vjetor.

LA ka filluar të realizojë edhe aktivitetet e Monitorimit në Terren, duke ndihmuar grantmarrësit me këshilla praktike dhe të drejtpërdrejta në lidhje me çështjet e zbatimit. Bazuar në një grafik të hollësishëm për monitorimin në terren, LA realizoi 8 vizita monitorimi deri në Qershor 2016, fokusi i të cilave ishte mbështetja dhe këshillimi i grantmarrësve individë. Vizita të tjera do të pasojnë menjëherë pas periudhës së raportimit.

Kapitulli 4: Perspektiva gjinore

Perspektiva gjinore është një temë transversale e LA dhe ka qenë në qendër të vëmendjes gjatë kësaj periudhe raportimi. Nga njëra anë, LA ka punuar që kapacitetet e personelit të vet në këtë fushë të kultivohen dhe të jenë solide. Për më tepër, LA donte të ishte e sigurt që parimet gjinore të përqafoheshin nga të gjithë aplikantët potencialë me të cilët ka kontaktuar si elektronikisht, ashtu edhe në Sesionet e Informimit.

Në të njëjtën kohë, LA ka punuar për të përfshirë parimet gjinore në dokumentacionin e punës, konkretisht në PVO/YPO, në Rregulloren e Bordit Këshillimor dhe të Bordit të Granteve, në Udhëzuesit për Aplikantët, si edhe në thirrjet për aplikime. Secili nga këto dokumente u kontrollua disa herë nga pjesëtarët e personelit të LA në kontekstin e Politikës së Perspektivës Gjinore të LA, që është hartuar me mbështetjen e një Eksperti Gjinor. LA është siguruar që elementi gjinor të jetë i dukshëm në të gjithë objektivat/drejtimitet e thirrjeve për aplikime. Gjithashtu, përbën një nga kriteret kryesore të vlerësimit për grantet.

Gjatë Thirrjes nr. 1 për Aplikime, LA ka kontraktuar dy organizata që punojnë me çështjet e të drejtave të grave, ndërsa më shumë se 50% e grantmarrësve individë (4 nga 7 kontraktuar) janë gra. Gjatë vizitës monitoruese në terren, LA është siguruar që grantmarrësit/individët të respektojnë Protokollin e Perspektivës Gjinore të LA, e cila i bashkëngjitet si Shtojcë kontratës së grantit.

Kapitulli 5: Financat dhe menaxhimi


Buxheti i miratuar i LA për vitin e parë të projektit (1 Korrik 2015 - 30 Qershor 2016) ishte 1,004,835 CHF. Gjatë kësaj periudhe, LA ka finalizuar procesin e dhënies së granteve për aplikimet e Thirrjes nr. 1 për Aplikime. Konkretisht, LA ka dhënë:

- 22 kontrata granti nën Thirrjen nr. 1 për Aplikime dhe 1 kontratë Reagimi të Shpejtë, me buxhet total 439,137 CHF.

Buxheti i planifikuar për grantet ishte 439,789 CHF, pra LA arriti të kontraktojë 99.9% të buxhetit total të planifikuar. Nga këto 22 kontrata:

- 15 grante iu janë dhënë OJF-ve me buxhet total 361,848 CHF;
- 7 grante iu janë dhënë individëve me buxhet total 63,038 CHF;
- 1 grant nga Reagimi i Shpejtë me buxhet 14,251 CHF.

GRANTET E KONTRAKTUARA



LA iu jep mbështetje dhe këshillim të vazhdueshëm grantmarrësve të kontraktuar, për të rritur kapacitetet e tyre dhe për të garantuar menaxhim dhe zbatim të suksesshëm dhe efikas të projekteve. Më poshtë jepet një përmbledhje e shumave të kontraktuara dhe të disbursuara gjatë periudhës së raportimit, e ndarë sipas OJF-ve dhe individëve:

	Shuma e kontraktuar * CHF		Shuma e disbursuar * CHF	
	OJF	Individë	OJF	Individë
Shuma sipas kategorisë	376,099	63,038	225,840	1,970
Totali	439,137		227,810	

Kapitulli 6: Mësimet e nxjerra

LA ka mbledhur në mënyrë proaktive komente nga aplikantët, Konsorciumi, Bordi i Granteve dhe donatori për të përmirësuar më tej proceset e thirrjeve për aplikime, Sesioneve të Informimit dhe Konkurseve të Ideve. Këto kontribute iu bashkuan vërejtjeve rreth pyetjeve të hapura dhe supozimeve gjatë fazës së hartimit të projektit. Me përvojën e një viti, LA tashmë i ka shumë më të qarta disa nga problematikat relevante të zhvillimit të demokracisë vendore. Mësimet kryesore të nxjerra gjatë vitit të parë të zbatimit dhe Thirrjes nr. 1 për Aplikime përfshijnë:

- Ka pasur interes të madh nga individët dhe grupet e individëve për të aplikuar për grante. Hipoteza fillestare ishte se programet klasike të granteve në Shqipëri, që fokusohen ekskluzivisht te OJF-të, e kanë anashkaluar kërkesën e ndrydhur të individëve të hapur dhe të shtuar, që duan të veprojnë në dobi të demokracisë vendore. Rreth 19% e pjesëmarrësve në Sesionet e Informimit dhe 30% e totalit të aplikimeve janë dorëzuar nga individë. Por, vlerësimi i aplikimeve tregoi se kapacitetet individuale për të hartuar propozime bindëse janë të dobëta, edhe pse shumë nga individët në fjalë kanë kredenciale solide profesionale.
- Procesi i menaxhimit të grantit për individët ka qenë sfidë e konsiderueshme gjatë vitit të parë, për shkak të kapaciteteve të dobëta të grantmarrësve individë dhe mbingarkesës me aspektet administrative. LA konstaton se në fazën e ardhshme të projektit, ekziston një nevojë e madhe për të asistuar dhe për të këshilluar individët për formulimin e propozimeve cilësore dhe për zbatimin efikas të tyre;
- LA vuri re mungesën e qartë të informacionit te popullata e gjerë, si edhe tek shumë të interesuar për të ndërmarrë projekte me LA, rreth funksioneve dhe kompetencave të njëjësive të qeverisjes vendore. Kjo dinamikë doli në pah sidomos në Sesionet e Informimit, ku pjesëmarrësit kishin njohuri të pakta për funksionet dhe përgjegjësitë (p.sh. planifikimi urban, shërbimet publike) të qeverisjes vendore dhe prireshin të ngrinin çështje me rëndësi politike kombëtare;